

**URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2000/7**

**ZBATIM I RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2000/20 MBI ADMINISTRIMIN DHE  
PROCEDURAT TATIMORE E DATËS 12 PRILL 2000**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë me nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/20 të datës 12 prill 2000 mbi Administrimin dhe procedurat tatimore,

Shpall këtë Urdhëresë administrativ:

Neni 1

Themelimi i bordit të pavarur për rishqyrtim

- 1.1 Me këtë themelohet Bordi i pavarur për rishqyrtim (më tej “bordi”), për të pranuar dhe shqyrtuar ankesat e tatimpaguesve që kanë të bëjnë me vendimet përfundimtare të marra nga Administrata tatimore.
- 1.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të emërojë tre anëtarë për të punuar në Bord. Anëtarët janë të pavarur nga Organi Qendror Fiskal dhe do të kenë një përfaqësues nga bashkësia afariste e Kosovës.
- 1.3 Për emërimin e parë të anëtarëve, pas hyrjes në fuqi të kësaj Urdhërese administrative, një anëtar do të emërohet për një afat njëvjeçar, ndërsa dy anëtarët e tjerë emërohen për një afat prej dy vitesh. Së këndejmi, emërimi i të gjithë anëtarëve mund të përitet për afatet e mëtejme dyvjeçare.
- 1.4 Në rast të papërshtatshmërisë për të shërbyer, paaftësisë, vdekjes apo dorëheqjes së një anëtari, që ndodh gjatë mandatit të emërimit, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të emërojë një anëtar tjetër. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do ta ketë fjalën përfundimtare sa i përket emërimit apo shkarkimit të anëtarit nga Bordi.

1.5 Bordi punëson personel profesional kompetent dhe vendos për rregullat e veta procedurale, duke përfshirë kushtet, në të cilat tatimpaguesit mund t'i lejohet zgjatja e afatit brenda të cilit paraqesin kërkesat e tyre.

### Neni 2

#### Ankesat drejtuar Bordit të pavarur për rishqyrtim

- 2.1 Tatimpaguesi, i cili ka marrë vendimin përfundimtar nga Sektori për ankesa i administrimit të taksave, mund t'i ankohet Bordit për ta rishikuar vendimin.
- 2.2 Ankesa nga tatimpaguesi drejtuar Bordit duhet të bëhet në pajtim me nenin 7 të Rregullores nr. 2000/20 të datës 12 prill 2000 mbi administrimin e taksave dhe procedurave dhe në pajtim me rregullat dhe procedurat e pëcaktuara nga Bordi.
- 2.3 Ankesa e tatimpaguesit drejtuar Bordit bëhet falas.

### Neni 3

#### Funksionet e Bordit të pavarur për rishqyrtim

- 3.1 Bordi udhëheq seancën e shqyrtimit dhe i shqyrton dëshmitë relevante, dokumentet dhe dëshmitë e tjera të paraqitura nga tatimpaguesi dhe Administrata e taksave.
- 3.2 Bordi e diskuton rastin në formë jurie dhe i njofton palët për vendimet e tij, të shoqëruara me arsyet e dhëna me shkrim për vendimin e marrë, brenda një afati prej 30 (tridhjetë) ditësh pas përfundimit të shqyrtimit. Vendimi i Bordit mirret mbi bazën e shumicës.
- 3.3 Vendimi i Bordit është obligativ si për tatimpaguesin, ashtu edhe për Administratën e taksave, nëse nuk ndryshohet ose refuzohet nga ana e gjyqit.

### Neni 4

#### Fshehtësia e informatave të tatimpaguesit

Anëtarët e Bordit duhet t'i ruajnë fshehtësitë e të gjitha informacioneve të tatimpaguesit me të dhënat e siguruara edhe pas përfundimit të mandatit të emërimit të tyre.

### Neni 5

#### Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 12 prill 2000.

Bernard Kouchner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm